

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

LIGJI Nr. 02/L-121

PËR VENDBANIMIN DHE VENDQËNDRIMIN

Kuvendi i Kosovës,

Në mbështetje të Kreut 9.1.26 pika (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001), me qëllim të vendosjes së rregullave ligjore për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin.

Miraton këtë:

LIGJ PËR VENDBANIMIN DHE VENDQËNDRIMIN

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Me këtë ligj në mënyrë unike rregullohet lajmërimi dhe ç'lajmërimi i vendbanimit dhe vendqëndrimit të qytetarëve, lajmërimi dhe ç'lajmërimi i mysafirit, ndërrimi i adresës së banimit, kompetenca dhe mënyra e mbajtjes së evidencave përkatëse.

Neni 2
Përkufizimet

Në këtë ligj shprehjet e përdorura kanë këtë domethënie:

“Qytetari” - është shtetasi i Kosovës apo i huaji, i cili sipas dispozitave të këtij ligji duhet të kryej obligimin e lajmërimit dhe ç'lajmërimit;

“Vendbanimi” - është vendi në të cilin qytetari vendoset me qëllim që të jetojë përgjithmonë;

“Vendqëndrimi” - është vendi në të cilin qytetari qëndron përkohësisht për shkak të punës, shkollimit apo arsyeve të tjera, mirëpo në të nuk ka për qëllim të jetojë gjithmonë;

“Bashkësia familjare” - është grup individësh të afërm me njëri tjetrin me lidhje gjaku, martesë, lidhje bashkëjetesë apo adoptim që deklarojnë, se jetojnë së bashku dhe së bashku shfrytëzojnë të ardhurat për plotësimin e nevojave themelore jetësore;

“Objektet e banimit” - janë hapësirat të dedikuara për banimin e qytetareve (shtëpitë për të vetmuarit, konviktet e nxënësve dhe studentëve, shtëpitë e pleqve, qendrat sociale-kujdestare dhe objektet tjera të dedikuara për banim grupor apo kryerjen e veprimtarive) që përfshin banim 24-orësh;

“Objektet turistike dhe hoteliere” - janë hapësirat, të dedikuara për pranimin e qytetarëve për fjetje apo pushim (hotelet, motelet, qendrat rehabilituese, shtëpitë turistike në fshat, kampet, shtëpitë malore që shfrytëzohen për fjetje apo pushim);

“Qiradhënësi” - është person juridik apo fizik që me pagesë pranon mysafirët në fjetje, pushim apo në kuadër të veprimtarisë së vet i ofron vendosje të përkohshme qytetarit;

“Regjistri i banimit të përhershëm” është përmbledhje e të dhënave për qytetarët të cilët kanë vendbanim dhe vendqëndrim të përhershëm në Kosovë;

“Evidence e mysafirëve” - është evidenca e mbajtur me kompjuterë apo me dorë, të qytetareve të pranuar në fjetje, pushim apo qëndrim të përkohshëm.

Neni 3

Detyrimi i lajmërimit dhe ç'lajmërimit

3.1 Qytetari është i detyruar të lajmërojë vendbanimin dhe ndryshimin e adresës së banimit nëse ai/ajo për herë shpërngulet nga Kosova.

3.2 Qiradhënësi duhet të lajmërojë dhe ç'lajmërojë mysafirin si dhe vendqëndrimin e përkohshëm të tij, ashtu si e parasheh ky ligj.

Neni 4

Kompetencat

Lajmërimi i vendbanimit të përhershëm apo të përkohshëm të qytetarëve, bëhet në zyrat e gjendjes civile në territorin e komunës përkatëse, (në tesktin e mëtejshëm- organi kompetent).

KREU II

LAJMËRIMI DHE Ç'LAJMËRIMI I VENDBANIMIT DHE LAJMËRIMI I ADRESËS SË BANIMIT

Neni 5

Detyrimi i lajmërimit, të vendbanimit si dhe lajmërimi i ndërrimit të adresës së banimit

5.1 Qytetari me rastin e ndërrimit të vendbanimit, ndërrimit të adresës së banimit apo kur zhvendoset nga ndonjë lagje, duhet të lajmërojë organin kompetent.

5.2 Për qytetarin më të ri se 18 vjeç si dhe qytetarin që nuk është i aftë, lajmërimin e vendbanimit duhet ta bëjë prindi, përfaqësuesi i tij/saj ligjor apo kujdestari.

5.3 Qytetari më i vjetër se 16 vjeç, i cili sipas dispozitave ligjore ka fituar të drejtën e punësimit, është i obliguar që të lajmërohet personalisht te organi kompetent.

5.4 Në rastin kur prindërit jetojnë të ndarë, fëmiun e lajmëron, ç'lajmëron ai prind që ushtron të drejtën prindërore.

5.5 Lajmërimi i ndërrimit të adresës së banimit bëhet në afatin prej 8(tetë) ditësh nga dita e vendosjes tek organi kompetent i vendbanimit të ri. Organi kompetent i vendbanimit të ri e njofton organin kompetent të vendbanimit të vjetër të qytetarit lidhur me këtë ndryshim.

5.6 Organi kompetent, me rastin e regjistrimit ose çregjistrimit të vendbanimit duhet ta pajisë qytetarin me certifikatën e vendbanimit i cili është i vetmi dokument zyrtar që dëshmon vendbanimin e qytetarit.

Neni 6

Procedura e lajmërimit, ç'lajmërimit të vendbanimit si dhe lajmërimi i ndërrimit të adresës së banimit

6.1 Organi kompetent me akt nënligjorë përcakton përmbajtjen e të dhënave personale të qytetarit për:

- a) emrin dhe mbiemrin;
- b) numrin personal;
- c) datën e lindjes;
- d) gjininë;
- e) vendin e lindjes;
- f) vendbanimin e vjetër;
- g) vendbanimin e ri;
- h) shtetësinë;
- i) gjendjen martesore;
- j) emrin, mbiemrin si dhe numrin personal të personit që udhëheqë bashkësinë familjare, si dhe marrëdhëniet familjare me atë person;
- k) datën e lajmërimit apo ç'lajmërimit gjegjësisht ndërrimit.

6.2 Lajmërimi, ç'lajmërimi i vendbanimit dhe ndërrimi i adresës së banimit bëhet në formularin për lajmërim, gjegjësisht ç'lajmërim të vendbanimit.

6.3 Qytetari gjatë lajmërimit të vendbanimit, lajmërimit të ndërrimit të adresës së banimit paraqet dëshminë, që ai/ajo ka të drejtë banimi në adresën që ai/ajo e lajmëron. Si dëshmi që qytetari ka të drejtë banimi në atë adresë konsiderohen dëshmitë mbi pronësinë, kontrata e qirasë me qiragjinë apo pëlqimi me shkrim i pronarit apo bashkëpronarit të banesës.

6.4 I huaji gjatë lajmërimit të vendbanimit, ndërrimit të adresës së banimit, përpos dëshmisë nga paragrafi 3 i këtij neni, i bashkëngjit edhe lejen për qëndrim të përhershëm në Kosovë.

6.5 Organi kompetent vërteton saktësinë e adresës, në të cilën qytetari paraqitet, në regjistrin përkatës, kurse në rastin e lajmërimit të vendbanimit dhe ndërrimit të adresës së te huajit edhe vlefshmërinë e lejes për qëndrim në Kosovë.

6.6 Nëse organi kompetent gjatë lajmërimit të vendbanimit të përhershëm dhe ndërrimit të adresës së banimit dyshon për saktësinë e të dhënave, gjegjësisht qytetari gjatë lajmërimit të vendbanimit nuk paraqet dëshmitë nga paragrafi 3 i të këtij neni, ky organ mundë ta refuzoj lajmërimin e vendbanimit, derisa të vërtetojë saktësinë e të dhënave të paraqitjes, mirëpo jo me shume se për 60 (gjashtëdhjetë) ditë.

Neni 7
Procedura e përcaktimit të vendbanimit

7.1 Nëse organi kompetent dyshon, që qytetari nuk banon në vendin (adresën) ku ai/ajo ka lajmëruar vendbanimin, ai fillon procedurën për përcaktimin e vendbanimit të vërtetë. Organi kompetent këtë procedurë e fillon edhe në rastet kur qytetari është shpërngulur përgjithmonë nga Kosova.

7.2 Në rastin, kur gjatë procedurës vërtetohet se, qytetari jeton në territorin e një komune tjetër, përcaktimi i vendbanimit i bartet organit kompetent në komunën në të cilën qytetari jeton përherë.

7.3 Nëse qytetari nuk e ka të lajmëruar vendbanimin, vendbanim i konsiderohet adresa e organit apo organizatës, ku ai/ajo merr ndihmë materiale:

a) organi kompetent duhet para lajmërimit të vendbanimit të merr pëlqimin me shkrim prej organit apo organizatës, që qytetarit i jep ndihmë;

b) nëse organi apo organizata nuk jep pëlqim me shkrim, organi kompetent e lajmëron përgjithmonë qytetarin në adresën e atij organi apo organizate e cila qytetarit i ka dhënë ndihmën e fundit materiale;

c) organet dhe organizatat që i ofrojnë ndihmë materiale qytetarit, duhet që gjatë lajmërimit të vendbanimit të bashkëpunojnë me organin kompetent.

7.4 Organi kompetent duhet ta lajmërojë organin apo organizatën, për lajmërimin e vendbanimit të qytetarit nga paragrafi 3 i këtij neni në adresë të tij.

7.5 Në bazë të vendimit me të cilin organi kompetent përcakton vendbanimin e vërtetë të qytetarit e shënon në regjistrin e banimit vendbanimin e ri, gjegjësisht e ç'lajmëron vendbanimin në rastin e shpërnguljes së përhershme nga Kosova.

7.6 Nëse organi kompetent nuk mundet të përcaktojë vendbanimin e vërtetë të qytetarit, me vendim e fshinë qytetarin nga regjistri i banimit të përhershëm.

KREU III
LAJMËRIMI DHE Ç'LAJMËRIMI I VENDQËNDRIMIT

Neni 8
Detyrimi i lajmërimit nga qiradhënësi

8.1 Qytetarin që përkohësisht banon në objektin turistik, hotelieri apo banesor, qiradhënësi duhet që ta lajmëroj gjegjësisht ta ç'lajmërojë, pa mare parasysht kohëzgjatjen e banimit.

8.2 Qytetari duhet që gjatë lajmërimit gjegjësisht ç'lajmërimit t'i jap qiradhënësit të dhënat nga pikat a, b, c, d, g h dhe k të paragrafit 1 të nenit 6 të këtij ligji.

8.3 Nëse qytetari më i ri se 16 vjet, vendoset së bashku me prindër, kujdestarë apo anëtarë të ngushtë të familjes, këta janë të obliguar gjatë lajmërimit gjegjësisht ç'lajmërimit ti japin qiradhënësit të dhënat për të nga pikat a,b,c,d dhe h të paragrafit 1 të nenit 6 të këtij ligji.

8.4 Gjatë lajmërimit gjegjësisht ç'lajmërimit të grupeve të organizuara, që kanë më së paku tetë njerëz dhe vendosja e tyre nuk zgjatë më shumë se 7(shtatë) ditë, udhëheqësi i grupit duhet ti dorëzoj te dhënat qiradhënësit për anëtarët e grupit, ku për secilin posedon të dhënat nga pikat a,b,c,d,g dhe h të paragrafit 1 të nenit 6 të këtij ligji

8.5 Qiradhënësi duhet të vërtetojë saktësinë e këtyre të dhënave.

Neni 9 Regjistrimi i Vendqëndrimit

9.1 Qytetari që vendoset në objektet turistike apo në objektet hotelerie, pronari i objektit duhet ta regjistrojë në regjistrin sipas formës së paraparë.

Neni 10 Detyrimi i lajmërimit të qytetarit

10.1 Qytetari që banon përkohësisht në objektet, siç janë shtëpitë për pushim, banesat apo objektet tjera, mirëpo jo në objektet nga paragrafit 1 i nenit 8 të këtij ligji, duhet të lajmërohet respektivisht të ç'lajmërohet në organin kompetent për këtë vendqëndrim, nëse ai/ajo mendon që në këtë vend të banojë më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Vendqëndrimin nga paragrafi 1 i këtij neni qytetari duhet ta lajmërojë brenda 7 (shtatë) ditëve prej ditës së vendosjes, kurse ta ç'lajmërojë para shpërnguljes.

10.3 Qytetari gjatë lajmërimit, ç'lajmërimit të vendqëndrimit duhet ti japë organit kompetent adresën e banimit, në të cilin lajmërohet si dhe të dhënat nga pikat a, b, c, d, g, h dhe k të paragrafit 1 të nenit 6 të këtij ligji.

10.4 Për lajmërimin e vendqëndrimit përdoren dispozitat nga neni 5 dhe 6 të këtij ligji.

Neni 11 Lajmërimi i shkuarjes së përkohshme nga Kosova dhe kthimi në Kosovë

11.1 Qytetari që do të largohet nga Kosova për më shumë se tre muaj, duhet që të lajmërojë organin kompetent, para se të udhëtojë.

11.2 Qytetari që kthehet në Kosovë, dhe që ka për qëllim banimi të përhershëm, duhet që brenda 8 (tetë) ditëve pas kthimit të lajmërojë organin kompetent për kthimin e tij/saj.

11.3 Gjatë lajmërimit për shkuarje të përkohshme respektivisht kthimit, qytetari duhet ti japë organit kompetent të dhënat nga paragrafi 3 i nenit 10 të këtij ligji.

11.4 Shkuarja e përkohshme respektivisht kthimi lajmërohet në formular për lajmërimin e shkuarjes së përkohshme nga Kosova respektivisht kthimit në Kosovë.

11.5 Për lajmërimin e shkuarjes së përkohshme nga Kosova respektivisht kthimit në Kosovë, zbatohen dispozitat nga neni 5 dhe 6 të këtij ligji.

Neni 12 Moslajmërimi i vendqëndrimit

Lajmërimi i vendqëndrimit nuk nevojitet për qytetarët nëse:

- a) vendosen në objektet e Ministrisë për Punët e Brendshme, policisë, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, që janë të dedikuara me qëllim të kryerjes së shërbimit.
- b) vendosen në spital apo në ndonjë ent tjetër shëndetësor për shkak të shërimit;
- c) janë në ente për vuajtjen e dënimit (burg) dhe shtëpitë përmirësuese;
- d) vendosen në qendrat për viktimat e dhunës në familje;
- e) janë anëtar të forcave për mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmës, që me ftesën e Kosovës marrin pjesë në evitimin e pasojave të fatkeqësive natyrore;
- f) kanë lidhur marrëveshjen për kryerjen e obligimeve ushtarake, për shkak të kryerjes së shërbimit adekuat civil apo detyrave tjera të përcaktuara për mbrojtje dhe shpëtim.

Neni 13 Mbajtja e evidencës së mysafirëve

13.1 Qiradhënësi është i obliguar që zyrtarit të organit kompetent apo policisë, tu mundësojë qasje në evidencën e mysafirëve dhe t'iu përcjellë të dhënat nga evidenca nëse kjo kërkohet, në pajtim me dispozitat ligjore.

13.2 Në evidencën e mysafirëve regjistrohet qytetari, që vendoset të qiradhënësi apo që përkohësisht qëndron tek ai.

13.3 Për saktësinë e të dhënave që shënohen në evidencën e mysafirëve është përgjegjës qiradhënësi, respektivisht personi i punësuar të qiradhënësi.

Neni 14 Metodologjia e mbajtjes së të dhënave në evidencën e mysafirëve

Formën e mbajtjes së të dhënave në evidencën e mysafirëve e cakton Ministria e punëve të Brendshme.

Neni 15 Kohëzgjatja dhe përtëritja e lajmërimit të vendqëndrimit

15.1 Lajmërimi i vendqëndrimit mund të zgjasë më se shumti një vit.

15.2 Në rastin e vazhdimin të vendqëndrimit duhet që qiradhënësi respektivisht qytetari ta përtërijë lajmërimin e vendqëndrimit në afat prej tetë ditëve pas kalimit të afatit nga paragrafi 1 i këtij neni.

15.3 Konsiderohet që qytetari nuk është i lajmëruar, nëse pas kalimit të 1 (një) viti, në afat prej 8 (tetë) ditëve nuk përtërinë lajmërimin për vendqëndrimin e tij/saj.

Neni 16 Regjistri i vendbanimit

16.1 Mbikëqyrjen e regjistrit për lajmërimin dhe ç'lajmërimin e vendbanimit dhe vendqëndrimin e bënë Ministria e Punëve të Brendshme.

16.2 Për mbledhjen, përpunimin, ruajtje , ndërmjetësimin dhe përdorimin e të dhënave nga regjistri i vendbanimit dhe evidencën sipas këtij ligji, aplikohen dispozitat e ligjit, që rregullojnë ruajtjen e të dhënave personale, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

16.3 Organi kompetent mbledhë të dhënat personale drejtpërdrejtë nga qytetari dhe qiradhënësi.

16.4 Vërtetimi i saktësisë së të dhënave në regjistrin e vendbanimit, është kompetencë e organeve të përcaktuara me këtë ligj.

16.5 Për mbledhjen e të dhënave personale nga qiradhënësit apo nga mbledhjet e të dhënave që tani ekzistojnë organi kompetent nuk është i obliguar ta lajmërojë qytetarin.

16.6 Qiradhënësit mbledhin të dhënat personale drejtpërsëdrejti nga qytetari.

16.7 Të dhënat personale nga regjistri i vendbanimit dhe evidencat sipas këtij ligji, mund ti përdorin zyrtarët e Ministrisë për punë të Brendshme, Policia dhe shfrytëzuesit e tjerë që janë kompetent sipas ligjit.

Neni 17 Udhëheqja dhe mbajtja e regjistrit të vendbanimit

17.1 Zyra e gjendjes civile udhëheqë dhe mbanë regjistrin e vendbanimit për territorin e vet dhe ja përcjellë Ministrisë për Punë të Brendshme që udhëheqë dhe mbanë regjistrin e vendbanimit të Kosovës.

17.2 Regjistri nga paragrafi 1 i këtij neni përmban të dhëna nga:

- a) paragrafi 1 i nenit 6 të këtij ligji;
- b) paragrafi 3 i nenit 10 të këtij ligji;
- c) e drejta për zgjedhje (votim).

17.3 Në regjistrin e vendbanimit mbahet edhe evidenca e bashkësisë familjare dhe përmban të dhënat nga pikat a,b,c,d,g,h,k të paragrafit 1 të nenit 6 të këtij ligji.

17.4 Zyra e gjendjes civile e mbanë regjistrin e vendbanimit në mënyrë elektronike dhe manuale që drejtpërsëdrejti janë të lidhura me regjistrin qendror të vendbanimeve.

17.5 Të dhënat për qytetaret, që kanë vdekur, apo përgjithmonë janë shpërngulur nga Kosova, ruhen në regjistrin e vendbanimit edhe 100(njëqind) vjet pas ngjarjes, pastaj i dorëzohen për ruajtje arkivit të Kosovës.

Neni 18 Sigurimi i të dhënave shfrytëzuesit

18.1 Organi kompetent, te i cili qytetari ka lajmëruar respektivisht ç'lajmëruar vendbanimin apo vendqëndrimin, i jep të dhënat nga paragrafi 2 i nenit 17 të këtij ligji, shfrytëzuesve, që i përdorin për mbajtjen e regjistrave dhe evidencave nga fusha e veprimin të tyre nëse për shfrytëzimin e këtyre të dhënave janë të autorizuar me ligj.

18.2 Të dhënat nga paragrafi 1 i këtij neni, mund t'i japë për shfrytëzim, Ministria për Punë të Brendshme.

Neni 19

Përdorimi i të dhënave nga organi kompetent në lidhje me evidencat e tjera

Të dhënat nga regjistri i vendbanimit mund të shërbejnë edhe për qëllim të ndërlikjes së tyre me të dhënat tjera si: të dhënat nga evidencat për letërnjoftimin, dokumenti i udhëtimit, regjistri i automjetit, leja e vozitjes, leja për armë, dhe evidencave tjera që i mbanë organi kompetent.

KREU IV DISPOZITAT NDESHKUESE

Neni 20

20.1 Me gjobë prej 500 (pesëqind) € deri në 1500 (njëmijepesëqind) € do të dënohet për kundërvajtje personi juridik që:

- a) nuk e lajmëron respektivisht ç'lajmëronë qytetarin, që vendoset apo përkohësisht banon në objektin turistik, hoteleri apo objekt banimi të paraparë në paragrafin 1 të nenit 8 të këtij ligji;
- b) nuk mbanë apo mbanë me mangësi evidencën e mysafirëve paragrafi 2 i nenit 13;
- c) në evidencën e mysafirëve nuk i shënon të dhënat e sakta të paraparë në paragrafin 3 të nenit 13 të këtij ligji;

20.2 Me gjobë prej 100 (njëqind) € deri 300 (treqind) € për kundërvajtje dënohet edhe personi përgjegjës i personit juridik, që bën vepër nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 21

Me gjobë prej 100 (njëqind) € deri 200 (dyqind) € do të dënohet për kundërvajtje personi fizik që:

- a) nuk e lajmëron respektivisht ç'lajmëron qytetarin, që vendoset apo përkohësisht banon në objektin turistik, hotelerie apo objekt banimi të paraparë në paragrafin 1 të nenit 8 të këtij ligji;
- b) nuk e mbanë apo mbanë me mangësi evidencën e mysafirëve (paragrafi 2 te nenit 13.);
- c) në evidencën e mysafirëve nuk i shënon të dhënat e sakta të paraparë në paragrafin 3 të nenit 13 të këtij ligji;

Neni 22

Me gjobë prej 50 (pesëdhjet deri në 100 (njëqind) € do të dënohet për kundërvajtje qytetari që:

- a) nuk e lajmëron vendbanimin dhe ndërrimin e adresës së banimit apo nuk ç'lajmëron vendbanimin e përhershëm të paraparë në paragrafët 1 dhe 3 të nenit 5 të këtij ligji;
- b) nuk e lajmëron respektivisht ç'lajmëronë qytetarin, më të ri se 18 vjet, si dhe qytetarin, që nuk është i aftë për punë të paraparë në paragrafin 2 të nenit 5 të këtij ligji;
- c) nuk e lajmëron respektivisht ç'lajmëronë fëmijun me rastin e ushtrimit të së drejtës prindërore të paraparë në paragrafin 4 të nenit 5 të këtij ligji;
- d) në afatin e caktuar nuk e lajmëron vendbanimin apo ndërrimin e adresës së banimit apo nuk e ç'lajmëronë banimin e përhershëm –të paraparë në paragrafin 5 të nenit 5 të këtij ligji;
- e) nuk e lajmëron gjegjësisht ç'lajmëron apo në afatin e caktuar nuk e lajmëron, ç'lajmëron vendqëndrimin të paraparë në paragrafin 1 të nenit 10 të këtij ligji;
- f) Nuk lajmërohet apo në afatin e caktuar nuk lajmëron shkuarjen e përkohshme nga Kosova respektivisht kthimin në Kosovë për më shumë se 60 ditë apo për qëllim, që aty të banojë përgjithmonë të paraparë në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 11 të këtij ligji.

Neni 23

Te gjitha mjetet e përfituara nga gjobat, derdhen në buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

KREU V DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 24

Organet mbikëqyrëse

Mbikëqyrjen për zbatimin e dispozitave të këtij ligj, e kryen Ministria për Punë të Brendshme.

Neni 25

Dispozitat përfundimtare

Ministria për Punë të Brendshme, në afat prej gjashtë muajve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji përcakton:

- a) formularët për lajmërimin e vendbanimit dhe vendqëndrimin të shkuarjes së përkohshme nga Kosova gjegjësisht kthimin në Kosovë;
- b) metodologjinë e mbajtjes së të dhënave në evidencën e mysafirëve, mënyrën e dhënies së të dhënave nga ajo dhe mënyrën e shkatërrimit të evidencës së mysafirëve;
- c) mënyrën e mbajtjes së regjistrit të vendbanimit dhe evidencën e bashkësisë familjare;
- d) mënyrën e dhënies së të dhënave nga neni 18 i këtij ligji.

Neni 26
Dispozitat e harmonizuara

26.1 Organi kompetent duhet që mbajtjen e regjistrit të vendbanimit dhe evidencat e bashkësisë familjare t'i harmonizojë dhe plotësojë me të dhënat që mungojnë nga paragrafi 2 dhe 3 të nenit 17 të këtij ligji në afat prej tri viteve pas aprovimit të tij.

26.2 Qiradhënësit duhet që mënyrën e udhëheqjes së të dhënave në evidencën e mysafirëve dhe dhënien e të dhënave nga ajo ti harmonizojnë me dispozitat e këtij ligji në afat prej një viti pas aprovimit të tij.

26.3 Deri te vendosja e evidencës, që do të përmbajë të dhënat për ndërtesat dhe banesat, të dhënat për vendbanim në Kosovës përcillen deri në nivelin e numrit të shtëpisë.

Neni 27

Ky ligj do te zëvendësoj të gjitha dispozitat e ligjit të aplikueshëm me të cilat është në papajtueshmëri me këtë ligj.

Neni 28
Aplikimi i ligjit

Dispozitat e këtij ligji vlejné për qytetarin, nëse me ligj ë veçantë apo me marrëveshje ndërkombëtare nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 29
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji nr. 02/L-121
27 shtator 2007

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,
Kolë Berisha
